




REPUBLIKA E KOSOVËS	REPUBLICA KOSOVA	REPUBLIC OF KOSOVO
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS	AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU	KOSOVO COMPETITION AUTHORITY
Nr.i Prot./Br. Prot./Prot.No.	160/24-0910	115
Nr.i Faz/Br. St./No.Pg.	13.03.2024	
Data/Datum/Date:	DOKUMENTI PRÌSTINA, PRÌSTINA	

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Nr.27/24

Prishtinë, më 13.03.2024

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 26, nenit 27, nenit 29, nenit 35, nenit 36 paragrafi 6 nenit 39 si dhe nenit 55 paragrafi 2 me nën paragrafin 2.4, i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimin Administrativ nr. 08/2023 për Përcaktimin e Keqpërdorimet të Pozitës Dominuese, bazuar në propozim/ kërkesën e parashtruar nga Adem Islamaj B.I. "PERENDIMI" me NUI: 810149064 adresat: Rruga "Eliot L. Engel", pn Pejë, përmes Avokatit Vehbi Halili Rr. "UÇK", Nr. 28 Prishtinë, përfaqësues i autorizuar i palës ankuese, kundër Bashkësisë Islame dega në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me datën 13.03.2024 merr këtë:

## K O N K L U Z I O N

Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun relevant, bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, konstatojmë se nuk ka argumente për fillimin e Procedurës Hetimore ndaj Këshillit të Bashkësisë Islame në Pejë, sipas nenit 36 paragrafi 6 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

## A r s y e t i m

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datën 03.10.2023, me Nr. Prot. 464/23-01H, ka pranuar propozim/kërkesën nga Adem Islamaj B.I. "PERENDIMI" me NUI: 810149064 adresat: Rruga "Eliot L. Engel", pn Pejë, kodi i veprimitarisë 9603 shërbime funerale dhe aktivitete tjera lidhur me to, përmes Avokatit Vehbi Halili Rr. "UÇK" Nr. 28 Prishtinë, përfaqësues i autorizuar i palës ankuese, kundër Bashkësisë Islame dega në Pejë.

### Pretendimet e paraqitësit të iniciativës:

Ndërmarrja Adem Islamaj B.I. "PERENDIMI" në ushtrimin e veprimitarisë pengohet nga Blime seli në Pejë, Bashkësia Islame duke e keqpërdorur pozitën e saj dominuese, udhëzon popullatën (xhematin) nëpër xhami se, nëse familjari i të ndjerit shkon tek firma private në fjalë, për të kërkuar shërbime, Bashkësia Islame nuk do të ofrojë shërbime ritual ose fetare nga Hoxha ku do qoftë.

Natyra, e punës së Bl-së nuk përkon me "sigurmin e dërrasave, arkivolit, sigurimin e shtofit (qefinit), përpos se botërisht është e njohur, se veprimitaria e Bashkësisë Islame është "ofrimi i riteve" për pjesën e komunitetit musliman, e në asnjë rast ofrimi i shërbimeve për shitblerjen e materialeve siç janë dërrasat, shtofi (qefini), piramidat, arkivolet.

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr. 1  
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: [info.konkurrenca@rks-gov.net](mailto:info.konkurrenca@rks-gov.net)

Fakti, tjetër që duhet ta ketë parasysh Autoritetit i Konkurrencës me rastin e vendosjes në çështjen e iniciuar nga Operatori, propozuesi i kërkesës është: se Bashkësia Islame në Pejë, nuk e posedon regjistrimin e veprimtarisë që e ushtron kundërligjshëm, për shitblerjen e materialeve dërrasat, shtofi (qefini), piramat, arkivolet.

## Takimi me përfaqësuesit e Bashkësisë Islame në Pejë, dhe Përshkrimi i Gjendjes Faktike të rastit

Me datën 22.02.2024, përfaqësuesit e Autoritetitit kanë zhvilluar takim në Bashkësinë Islame në Pejë, Përfaqësuesit e Bashkësisë Islame dega në Pejë, në këtë takim deklaruan se:

Bashkësia Islame është pa status, e njëjtë bazohet në Kushtetutën e Bashkësisë Islame dhe Ligjin për Liritë Fetare. Bashkësia Islame dega në Pejë, ofron të gjitha shërbimet funerale të varrimit, në këtë komunë janë pesë apo gjashtë ndërmarrje që merren me shërbime funerale. Familjarët e të vdekurit nuk kushtëzohen me u paraqitë në Bashkësi Islame, qytetarët nëse angazhojnë ndërmarrjen private për shërbime funerale, BI e lejon hoxhën të kryejë ritet fetare. Ndërmarrjes private i mundësohet shfrytëzimi i gusellhanën, murgut dhe të gjithë asetet e Bashkësisë Islame dega në Pejë. Hoxhallarët asnjëherë nuk kanë mbajtur ligjëratë nëpër xhami, se nëse familjarët e të vdekurve nuk lajmërohen në bashkësinë islame, ne nuk ofrojmë rite fetare.

Në Bashkësinë Islame dega në Pejë, nga pesë a gjashtë ndërmarrje që merren me shërbime funerale nuk ka pasur ankesa, vetëm nga Adem Ismajlaj ka pasur një ankesë, se gjëja se po ia cenojmë të drejtat biznesore, se gjëja se jemi duke e keqpërdour pozitën tonë, çka nuk është fare e vërtetë se nëse dikush e keqpërdor, është Adem Ismajlaj, përfaktin se, ai është i punësuar në spitalin rajonal në Pejë, dhe i njëjti e bënë të pa mundurën të na pengojë, ndikon te njerëzit që ata të shkojnë te ai, por ne asnjëherë nuk kemi bërë vërejtje, dhe nuk i kemi penguar atij që të shfrytëzon asetet e BI, pa asnjë problem.

Sipas deklarimeve të përfaqësueseve të Bashkësisë Islame dega në Pejë, qytetarin nuk e dëmtojnë, pavarësisht nëse shërbimet i merrë tek ndërmarrja private, BI i kryejmë ritet fetare që i takojnë pa asnjë problem. Çmimet e BI janë shumë më të ulëta se ndërmarrjet private, për shembull: Në BI bartja e kufomës nga spitali në morg ku pastrohet kufoma, te shtëpia e të ndjerit dhe te varrezat kushton 35 euro, ndërsa te ndërmarrja private kushton 100 euro.

Në Bashkësinë Islame dega në Pejë për shërbimet e larjes, dhe faljes së gjenezës kushtojnë 80 euro, Varri me beton kushton 450 euro, nga të cilat 390 i merr BI ndërsa 60 i paguhen komunës, varri pa beton kushton 130 euro, nga të cilat 70 euro i merr BI ndërsa 60 euro i merr komuna. Komuna e Pejës nuk i mbulon shpenzimet e varrimit, por vetëm qytetarëve të cilët marrin ndihma sociale janë të liruar nga pagesa, ndërsa ndërmarrja private nuk i lirojnë nga pagesa. Bashkësia Islame dega në Pejë, ka kontrata me Komunën për menaxhimin e varrezave, me Spitalin rajonal të Pejës, kontratë për pastrimin dhe groposjen e mbeturinave patologjike të larguara gjatë operacioneve si placentat pjesët e amputuara si dhe, Kontratë me Spitalin rajonal të Pejës, me të cilin e furnizon me qese speciale për mjekësi ligjore.

Bashkësia Islame dega në Pejë, ka të punësuar 3 punëtorë, të cilët e bëjnë hapjen e varreve në varrezat e qytetit si dhe mirëmbajtjen e tyre të cilat janë në menaxhim të Bashkësia Islame dega në Pejë, kjo e drejt është e bazuar në kontratën e lidhur ndërmjet Bashkësisë Islame, dega në Pejë dhe Komunës së Pejës. Varrezat në fshatra hapen nga varrmihësit e fshatit, familjarët apo ndërmarrjet private, si dhe nga Bashkësia Islame dega në Pejë.

## TREGU PËRKATËS APO RELEVANT

Tregu gjeografik - duke iu referuar nenit 4, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e tregut përkatës Nr. 01/2023, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Komunës së Pejës.

**Tregu i produktit – Shërbimet siç janë:** (Transporti i Kufomave, Piramidat, Arkivolet, Qefini, Dërrasat, si dhe Hapja dhe Rregullimi i Varrit).

### Analiza e Konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës, angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës (Abuzimit me Pozitën Dominuese, Marrëveshjeve të Ndaluara, Praktikave të Bashkërenduara dhe Realizimit të Përqendrimeve të Paligjshme) nga ndërmarrjet ekonomike private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga administrata shtetërore dhe entet irregulatorë në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.

Parimi themelor i ligjit dhe politikës së konkurrencës është të sigurojë qasje në treg të lirë për çdo ndërmarrje e cila i plotëson kushtet për të konkurruar ne atë treg në interes të përdoruesve të shërbimeve dhe të mund të konkurrojë me çmim dhe cilësi.

Objktivi kryesor i politikës së konkurrencës është ruajtja e procesit konkurrues dhe nxitja e konkurrencës efektive në treg. Ruajtja ose nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme, duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat apo ai shtetëror/publik mund t'i bëjnë konkurrencës. Prandaj ligji i konkurrencës ndalon marrëveshjet për fiksimin e çmimit, abuzimin me pozitë dominuese, si dhe përqendrimet që rrezikojnë të krijojnë një pozitë dominuese në treg.

Autoriteti në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe gjendjes faktike të konstatuar gjatë ekzaminimit paraprak të situatës në tregun përkatës, Këshilli i Bashkësisë Islame në Pejë, është prezent në treg së bashku me ndërmarrjet tjera, të cilët në mënyrë të pavarur sigurojnë klientët për t'i ofruar shërbimet konkurruese siç janë: Transportin e Kufomave, Piramidat, Arkivolet, Qefini, Dërrasat, si dhe Hapja dhe Rregullimi i Varrit.

Autoriteti konsideron se, shërbimet të cilat nuk janë konkurruese, të cilat i ofron vetëm Këshilli i Bashkësisë Islame në Pejë, si organizatë e thirrur për zhvillimin e riteve fetare janë: Shërbimet e Morgut, Pastrimi dhe falja e namazit të gjenazës, e cila është e obliguar dhe ofron ketë shërbim të gjithë qytetarëve të Komunës së Pejës, pavarësisht se cila ndërmarrje i kryen shërbimet e tjera konkurruese, kryerja e riteve fetare është e rregulluar me Kushtetutën e Bashkësisë Islame të Kosovës të vitin 2002, të cilat kryhen nga personat përgjegjës të deleguar nga Bashkësia Islame.

Autoriteti konsideron se, nga të dhënat/dëshmitë të siguruara gjatë shqyrtimit paraprak, tregojnë së nuk ka shkelje të konkurrencës në tregun në të cilin ofrohen shërbime konkurruese siç janë: (Transportin e Kufomave, Sënduku, Qefini, Dërrasat, si dhe Hapja dhe Rregullimi i Varrit), për shkak se Autoritetit nga pala-ankuesi nuk iu ofrua asnje provë mbi bazën e asaj se: Këshilli i Bashkësisë Islame në Pejë, ka udhëzuar qytetarët e Komunës së Pejës nëpër xhamia se, nëse familjarët e të ndjerit shkojnë tek firma private, për të kërkuar shërbime, Bashkësia Islame nuk do të ofrojë shërbime rituale ose fetare nga Hoxhallarët.

Gjithashtu, Autoriteti ka pasur parasysh deklaratën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Pejë, të marrë më 22.02.2024, se Hoxhallarët asnjëherë nuk kanë mbajtur ligjërata nëpër xhami, se nëse familjarët e të vdekurve nuk lajmërohen në bashkësi islame, ne nuk ofrojmë rite fetare. Autoriteti konsideron se deklarata/veprime e tille nuk parashihen në nenin 9 të Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 08/L-056, as në Udhëzimin Administrativ nr. 08/2023 për Përcaktimin e Keqpërdorimit të Pozitës Dominuese.

Për ta konstatuar keqpërdorimin e pozitës dominuese, duhen dëshmi e fakte të prekshme se cilët nga paragrafët dhe nen paragrafët të nenit 9 të LMK janë shkelur nga ndërmarrja. Nga ajo se çka u potencuar më sipër, në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që Këshilli i Bashkësisë Islame në Pejë, ka keqpërdorur me pozitën e saj dominuese në tregun në fjalë, duke zbatuar kushte të ndryshme për transaksione të barasvlershme me ndërmarrjet e tjera, duke i refuzuar ndërmarrjes tjetër qasje kundrejt shpërblimit të përshtatshëm në rrjet ose infrastrukturë, duke i vënë ato në pozitë të pafavorshme konkurruese, në kuptim të nenit 9, parografi 2 të LMK-se, nen paragrafët 2.3 dhe 2.6, pasi konstatohet se BIK-u, vepronte në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Autoriteti ka shqyrtuar kërkesën e ndërmarrjes, e cila ka kërkuar t'i ndërpritet veprimtaria e paligjshme e ushtruar nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Pejë, si dhe t'i ndërpritet konkurrenca dominuese në Pejë, Istog dhe Klinë. Se i përket kërkesës për ndërprerjen e veprimtarisë, Autoriteti konstaton se nuk është në kompetencën e të njëjtit.

Lidhur me ndalimin e pozitën dominuese ndaj Këshillit të Bashkësi Islame në Pejë, bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 08/L-056, nuk është e kundërligjshme që një ndërmarrje ose grupimi i ndërmarrjeve ta ketë pozitë dominuese, mirëpo nëse Autoriteti konstaton se ndërmarrja ose grupimi i ndërmarrjeve ka/kanë keqpërdor pozitën dominuese e bijën ndesh me nenin 9 të LMK-së, si dhe Udhëzimin Administrativ nr. 08/2023 për Përcaktimin e Keqpërdorimit të Pozitës Dominuese, në këto raste Autoriteti ndërmerr veprime duke u bazuar në nenin 10 të LMK-së, me të cilin i ndalon ndërmarrjes ose grupimin e ndërmarrjeve të vazhdojë veprimin që shkelë konkurrencën, përcakton masat, kushtet dhe afatet për mënjanimin e efekteve të dëmshme të veprimeve që shkelin konkurrencën, si dhe shqipton gjobë në pajtim me ligjin.

Në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe gjendjes faktike të konstatuar gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun përkatës, si dhe bazuar ne Udhëzimin Administrativ nr. 08/2023 për Përcaktimin e Keqpërdorimet të Pozitës Dominuese, për të parandaluar, kufizuar ose shtrembëruar konkurrencën në treg duke keqpërdorur pozitën dominues, duhet të plotësohen njëkohësisht dy kushte kumulative: që ndërmarrja specifike është në një pozitë dominuese në tregun përkatës në kuptim të nenit 8 të LMK-së dhe se ai keqpërdorë pozitën dominuese, në disa nga mënyrat e përcaktuara në nenin 9 të LMK-së.

Edhe pse është vërtetuar se BIK-u ka një pozitë dominuese në tregun e ofrimit të shërbimeve të varrimit për ritet fetare, d.m.th. një monopol ligjor, në kuptim të nenit 8 të LMK-se, gjendja faktike e vërtetuar nuk rezulton në ekzistimin e indikacioneve të mjaftueshme për fillimin e procedurës për konstatimin e keqpërdorimit të pozitës dominues ndaj BIK-ut në kuptim të nenit 37 të LMK-së dhe duke zbatuar nenin 9 të LMK-se, sa i përket pjesës së shërbimeve konkurruese.

Autoriteti vlerësoi veçanërisht faktin se, në bazë të ligjit, ndërmarrjet që kryejnë veprimtari përkatëse janë të autorizuara të organizojnë procedurën e varrimit në mënyrë të pavarur dhe se

kjo procedurë ndryshon nga njëra ndërmarrje në tjetrën (varësisht prej çmimit te pjesës së shërbimeve funerale, në përputhje me politikat e tyre).

Autoriteti pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, dokumentacionit të ofruar nga palët dhe takimeve të realizuara, erdhi në përfundim se nuk ka fakte dhe argumente mbi bazën e të cilave Autoriteti mund të filloj më inicimin e procedurës hetimore ndaj Këshillit të Bashkësisë Islame në Pejë.

Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, u vendos si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

Obligohet Sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij konkluzioni.

Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana Komisionit.

**AUTORITETI I KONKURRENCËS**  
**Komisioni**

**Neime Binaku - Isufi**

Kryetare



**Kaltrina Sela**

Nënkyetare



**Florent Mehmeti**

Anëtar



**Nafije Osdautaj**

Anëtare



**Salihe Gashi Loku**

Anëtare



**Këshilla juridike:** Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative në afat prej 30 ditësh, nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.

Me këtë KONKLUZION të njoftohen:

- *Paraqitësi i Iniciativës*
- *Publikohet në web faqen e Autoritetit*
- *Arkiva*

